



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura IV-të**

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 35/11

Prishtinë, më 16.11.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić dhe Duda Balje

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza, Lulzim Rafuna dhe Lum Mita-Ministria e Financave, Fadil Raçaj-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Rejhane Zylfijaj, Njomza Ilazi, Alexander Beetz dhe Ramadan Islami-GIZ, Haxhi Gashi-USAID, Sylë Ahmetaj-Kosova Sot, SBIRN, OSCE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Aurora Ademi dhe Njomza Halilaj (praktikante). Gjithashtu ishin të pranishëm edhe Daut Beqiri dhe Xheladin Hoxha nga administrata e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani – Zëvendëskryetar i parë i komisionit.

**Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-54 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre me raportin me amendamente të komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-80 për Lojërat e Fatit;**
- 4. Shqyrtimi i Propozim Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrim Evropian për vitin 2012;**
- 5. Shqyrtimi i kërkesës për procedim të vendimit për pagat e zëvendësve të Avokatit të Popullit të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 07.10.2011;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-68 për Qeverinë e Republikës së Kosovës me raportin me amendamente të komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**

## 7. Të ndryshme.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryesuesi**, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

### 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-54 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre me raportin me amendamente të komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

**Kryesuesi**, sqaroi që amendamentet e propozuara nga komisioni funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale përmbajnë implikime të jashtëzakonshme buxhetore dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet të merr një qëndrim në mënyrë që ligji i propozuar të jetë ligj i zbatueshëm dhe i bazuar në mundësitë financiare. Kemi marrë edhe rekomandime nga FMN-ja dhe Banka Botërore. Drafti ka qenë në rregull, mirëpo janë bërë disa ndryshime nga komisioni funksional me ç'rast kanë ngritur shqetësime për shkak të ngritjes së kostos së implementimit të këtij ligji.

**Bedri Hamza**, theksoi që Projektligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre është njëri prej ligjeve të sferës sociale që janë pjesë e marrëveshjes së institucioneve të Kosovës me institucionet financiare ndërkombëtare siç është FMN-ja. Ligji është sponsorizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ka qenë në harmoni me FMN-në. Edhe Ministria e Financave e ka dhënë deklaratën financiare për këtë draft, i cili ka kaluar edhe në lexim të parë në Kuvend, mirëpo janë bërë disa amendamente nga komisioni funksional me të cilat FMN-ja nuk është pajtuar. FMN-ja dhe Banka Botërore nuk është kundër që të rregullohet kjo çështje, mirëpo kërkon nga ministria sponsorizuese që të krijojë një komision, i cili do të merret me përcaktimin e kriterëve dhe metodologjisë se kush mund të jetë përfitues i këtyre beneficioneve dhe pastaj të vie deri te saktësimi i numrit të përfituesve të mundshëm nga ky ligj dhe caktimi i lartësisë së këtyre beneficioneve. Është menduar që në vitin 2015 të fillohet me dhënien e këtyre beneficioneve, por nëse kryhen procedurat teknike ka mundësi që këto beneficione të fillohen edhe në vitin 2014.

**Muhamet Mustafa**, pyeti se sa është vëllimi i implikimeve buxhetore me amendamentet e propozuara?

**Latif Gashi**, veçoi si çështje më të rëndësishme saktësimin e numrit të veteranëve, i cili numër është trefishuar dhe Ministri i Financave nuk mund të ketë njohuri për koston e këtij ligji kur ende nuk dihet numri i saktë i këtyre veteranëve. Ndërhyrjet e komisionit funksional i konsideroi si prishje të ligjit dhe propozoi që të gjitha ato amendamente që përmbajnë implikime buxhetore t'i rekomandohen komisionit funksional dhe të mos të miratohen.

**Sali Asllanaj**, theksoi që anëtarët e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale janë treguar të papërgjegjshëm në këtë aspekt, pasi që vullneti i të gjithëve është që të rregullohet kjo çështje, mirëpo gjithmonë duhet pasur parasysh mundësitë financiare. Propozimi fillestar ka qenë që për veteranët e luftës do të nxirret një ligj i veçantë dhe duhet të ketë kriterë strikte për vlerësimin e kësaj kategorie dhe ta gëzojnë ndihmën e shtetit ata të cilët me të vërtetë e meritojnë.

**Fadil Raçaj**, u përgjigj për numrin e veteranëve se ekziston një shifër prej 8.500-8.600 të përfshirë në kuadër të Departamentit të Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës, mirëpo ky numër nuk është i saktë aspak. Lidhur me këtë çështje, vitin e kaluar, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është themeluar një komision i veçantë për verifikimin e dokumentacionit për të gjitha kategoritë e dalura nga lufta, i cili komision është funksionalizuar para një muaji dhe sot në mbledhjen e Qeverisë është në rend të ditës shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për vlerësimin e kriterëve për veteranët e luftës dhe përcaktimin e metodologjisë së punës.

**Kryesuesi**, theksoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet të kërkoj na Komisioni funksional të rishqyrtojë Projektligjin dhe amendamentet e propozuara, që vlerësohen se përmbajnë implikime buxhetore, në mënyrë që në Kuvend të shkohet me amendamente unike. Për këtë çështje kërkoi sqarime nga Drejtori i Administratës së Kuvendit Daut Beqiri për aspektin procedural se a lejohet që Komisioni për Buxhet dhe Financa të kërkojë nga komisioni funksional që të rishqyrtojë edhe një herë këtë çështje.

**Latif Gashi**, propozoi që në kuadër të këtij raporti rekomandues të përfshihet edhe saktësimi i numrit të veteranëve të luftës, pasi që kjo paraqet një pengesë të madhe për ligjin.

**Daut Beqiri**, sqaroi se Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk e ndalon këtë propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa që t'i dërgojë këtë raport rekomandues komisionit funksional dhe i cili raport i plotëson kushtet formale dhe procedurale. Sugjeroi që ky raport t'i dërgohet edhe deputetëve të Kuvendit.

**Albana Fetoshi**, kundërshtoi futjen në këtë mënyrë të këtij raporti, pasi që është dashur që ky raport të dorëzohet së paku një ditë më herët në komision ose të formohet një grup punues dhe propozoi që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër.

**Sali Asllanaj**, përkrahu mendimin e parafolësës, mirëpo megjithatë mund të shkruhet një raport me një fjali për komisionin funksional duke kërkuar që të rishqyrtohet edhe një herë kjo çështje për shkak të kostos së madhe që e ka ky ligj dhe për të cilin nuk mund të marrim vendim si komision i përhershëm.

**Xhevdet Neziraj**, sugjeroi që do të kishte qenë më mirë që në këtë mbledhje të ishin edhe anëtarët e komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në mënyrë që të dyja komisionet të dalin me qëndrime të qarta dhe të harmonizuara.

**Muhamet Mustafa**, kërkoi që raporti me rekomandime t'u shpërndahet edhe anëtarëve të komisionit dhe të lexohet nga secili.

Komisioni me pesë vota për (Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), një kundër (Sali Asllanaj) dhe dy abstenime (Albana Fetoshi dhe Hykmete Bajrami) nxorri këtë:

## **REKOMANDIM**

1. Komisioni vlerësoi se disa nga amandamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në Projektligjin Nr. 04/L-54 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, kanë implikime financiare shtesë dhe nuk janë në përputhshmëri me Letrën e Qëllimit të Qeverisë dërguar FMN-së.

2. Komisioni, pas konsultimeve me Ministrin e Financave, Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kryetarin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ka vendosur që Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale t'i rekomandojë që të marrë në ri-shqyrtim Projektligjin Nr. 04/L-54 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, me rekomandimet si në vijim:

- a) **Amandamentet e propozuara nga Komisioni funksional që kane implikime financiare shtesë të cilat nuk janë të përcaktuara në kornizën afatmesme fiskale**

Amandamentet 1, 3, 4, 5, 6, 12, 13, 14, 15, 18, 19, 25, 28, 30, 33, dhe 38 **rekomandohet që të mos përfshihen në raportin me rekomandime i cili i dërgohet Kuvendit për miratim.**

ARSYETIM: këto amandamentet rrisin të drejtën e përfitimit duke shkaktuar implikime financiare shtesë, kostoja e të cilave nuk është e vlerësuar dhe nuk është paraparë në versionin e projektligjit të propozuar nga Qeveria. Poashtu këto amandamentet nuk janë në përputhje me Marrëveshjen e Arritur me FMN-në dhe kornizën afatmesme fiskale.

- b) **Amandamentet që nuk kanë implikime financiare shtesë:**

Amandamentet 2, 7, 8, 9, 10, 16, 17, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 29, 31, 32, 34, 35, 36, 37, 39 dhe rekomandohet që të përfshihen në raportin me rekomandime i cili i dërgohet Kuvendit për miratim

- c) **Amandamentet të propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa në projektligj**

#### **Amendamenti 1**

Neni 3 paragrafi 1.6 i projektligjit ndryshohet si vijon:

**“Dëshmor i Luftës Çlirimtare” është pjesëmarrësi i UÇK-se që:**

- a) **Ka rënë në luftë për lirinë e vendit nga 1997-1999**  
b) **Eshte plagosur në luftën për lirinë e vendit në periudhën 1997-1999 dhe ka vdekur nga plagët e marra brenda tre viteve”**

#### **Amendamenti 2**

Neni 3 paragrafi 1.7 i projektligjit ndryshohet si vijon:

**“Invalid i Luftës Çlirimtare” është luftëtari i UÇK-se, organizmi i të cilit është dëmtuar mbi 20% për shkak të plagës, lëndimit apo sëmundjes që ka pësuar në Luftë për Çlirimin e Kosovës, apo si i internuar (i burgosur) në burgjet apo kampet e armikut dhe shtetasi i huaj si veteran i UÇK-se, nga 1997-1999.**

#### **Amendamenti 3**

Neni 3 paragrafi 1.9 i projektligjit ndryshohet si vijon: në fund të fjalisë fshihet: **“brenda periudhës 30.12.1991 deri më 20.06.1999”**

dhe ndryshohen si në vijim: **“gjate periudhës 1997-1999”**

#### **Amendamenti 4**

Neni 5 paragrafi 1.1.5 i projektligjit ndryshohet si vijon:

Në fund të fjalisë fshihen fjalët: **“në vitet 1998-1999”**

dhe ndryshohen si ne vijim: **“gjate periudhës 1997-1999”**

#### **Amendamenti 5**

Pas nenit 26 shtohet neni 27 si vijon:

#### **Neni 27: Dispozita Kalimtare**

**“Ata përfitues që kanë gëzuar beneficione para datës 15 maj 2011 do të vazhdojnë t’i gëzojnë ato beneficione. Nëse gjatë procesit të auditimit bëhet e ditur se disa nga këto beneficione janë përfituar në mënyrë të padrejtë, atëherë këto beneficione do të ndërpriten”**

Në vazhdim bëhet rirenditja e neneve.

### **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-80 për Lojërat e Fatit**

**Bedri Hamza**, sqaroi se ky projektligj është iniciativë e Ministrisë së Financave dhe pjesë e Strategjisë Legjislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011 dhe është hartuar në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Prishtinë, përkatësisht Departamenti i Thesarit Amerikan. Nxjerrja e këtij ligji do ta konsolidojë dhe avancojë bazën ligjore për rregullimin e veprimtarisë së lojërave të fatit në Kosovë. Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të lojërave të fatit, licencimi i subjekteve, regjistrimi i punonjësve dhe themelimi i autoritetit për mbikëqyerjen e lojërave të fatit. Me qëllim të menaxhimit më të mirë të veprimtarisë së lojërave të fatit dhe inkasimit të tatimit të akcizës në lojërat e fatit për herë të parë në Kosovë i kemi caktuar kompetencat ATK-në si organ rregullator i veprimtarisë së lojërave të fatit dhe doganës si organ tatimblërës në lojërat e fatit. Projektligji parasheh edhe parimet themelore që kanë të bëjnë me largimin e elementeve kriminale dhe korruptive nga lojërat e fatit. Me këtë ligj kemi konstatuar që në Kosovë ende nuk janë krijuar kushtet për të lejuar lojërat e fatit elektronike, të cilat janë ndaluar me dispozitat e këtij projektligji. Po ashtu është rregulluar statusi, qeverisja, menaxhimi dhe e drejta e transferueshme dhe e përcaktuar e Lotarisë së Kosovës. Ky projektligj është në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, sidomos direktivat e BE-së, legjislacioni i vendeve të rajonit dhe përvoja amerikane në këtë fushë.

**Latif Gashi**, konsideroi që ky projektligj nuk përmban ndonjë kosto të madhe buxhetore dhe është përcaktuar brenda Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Po ashtu është një ligj që do të ndikojë pozitivisht në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

**Kryesuesi**, shprehu disa dilema lidhur me Lotarinë e Kosovës e cila ka qenë ndërmarrje shoqërore, ndërsa me ligj tani po kërkohet që të bëhet subjekt publik me interes të veçantë për Kosovën, pastaj është çështja e marrjes së përgjegjësisë së Qeverisë për detyrimet e themeluesit, garantimi i pagesave të fitimeve nga Qeveria e Kosovës dhe shumë çështje tjera.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

#### **REKOMANDIM**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr. 04/L-80 për Lojërat e Fatit

### **4. Shqyrtimi i Propozim Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrim Evropian për vitin 2012**

**Xheladin Hoxha**, sqaroi se plani i veprimit i Kuvendit për integrim është i nxjerrur mbi bazën e raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2011 dhe këtu janë veprimet e të gjitha komisioneve parlamentare që do të bëhen gjatë vitit 2012 dhe Komisioni për Integritet Evropian pret që deri më datën 18.11.2011 të gjitha komisionet t'ia dorëzojnë vërejtjet dhe sugjerimet, në të kundërtën miratohet ashtu siç është nga Komisioni për Integritet Evropian dhe procedohet për miratim në seancë plenare.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

#### **REKOMANDIM**

Miratohet Propozim Planit i veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012 dhe detyrat e Komisionit që dalin nga plan.

#### **5. Shqyrtimi i kërkesës për procedim të vendimit për pagat e zëvendësve të Avokatit të Popullit të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 07.10.2011**

**Kryesuesi**, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet në mbledhjen kur do të shqyrtohet buxheti i agjencioneve të pavarura.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

#### **REKOMANDIM**

Pagat e zëvendësve të Avokatit të Popullit të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 07.10.2011, do të trajtohen me rastin e shqyrtimit të Buxhetit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012.

#### **6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-68 për Qeverinë e Republikës së Kosovës me raportin me amendamente të komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Komisioni me gjashtë vota për (Naser Osmani, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), asnjë kundër dhe një abstenim (Albana Fetoshi) nxorri këtë:

#### **REKOMANDIM**

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

#### **7. Të ndryshime**

Nuk pati ndonjë çështje tjetër për të diskutuar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit**

---

**Naser Osmani**